

Fondacioni për zhvillimin e arsimit dhe kulturës ALBIZ shpall

K O N K U R S

Për ndarjen e **175 bursave** për studentë për vitin akademik **2022/2023**

I. MËNYRA E APLIKIMIT

Të drejtë për aplikim në këtë konkurs kanë studentët e ciklit të parë (studime deri diplomike) që studiojnë në ndonjë prej universiteteve shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Universitetin e Evropës Juglindore, si dhe Universitetin Ndërkombëtar Ballkanik, në ndonjë prej fakulteteve në vijim:

- ✓ Fakulteti Arkitekturës;
- ✓ Fakulteti i Ndërtimtarisë;
- ✓ Fakulteti Ekonomik;
- ✓ Fakulteti i Makinerisë ;
- ✓ Fakulteti i Shkencave të Mjekësisë;
- ✓ Fakulteti Pedagogjik;
- ✓ Fakulteti Juridik;
- ✓ Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore;
- ✓ Fakulteti Stomatologjik;
- ✓ Fakulteti Teknologjik – Metalurgjik;
- ✓ Fakulteti i Mjekësisë Veterinare;
- ✓ Fakulteti i Elektroteknikës dhe Teknologjisë Informative;
- ✓ Fakulteti i Shkencave Bujqësore dhe të Ushqyerit;
- ✓ Fakulteti i Shkencave Informatike dhe Inxhinierisë Kompjuterike;
- ✓ Fakulteti i Edukatës Fizike, Sport dhe Shëndet;
- ✓ Fakulteti Farmaceutik;
- ✓ Fakulteti Filozofik;
- ✓ Fakulteti Filologjik;
- ✓ Fakulteti i Pylltarisë;
- ✓ Fakulteti i Administrimit të Biznesit;
- ✓ Fakulteti i Shkencave të zbatuara;
- ✓ Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore;
- ✓ Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit;
- ✓ Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike;
- ✓ Fakulteti i Shkencave Islame;
- ✓ Fakulteti i Kulturës Fizike
- ✓ Dhe fakultete tjera që nuk janë përfshirë në listë(në Universitet e lartpërmendura).

II. KRITERIUMET PËR APLIKIM

1. Të jenë studentë të vitit të II, III, IV, V dhe VI;
2. Të jenë studentë të rregullt;
3. Të mos kenë përsëritur vit gjatë studimit;
4. Të mos jenë shfrytëzues të bursave ose kredive nga ndonjë institucion apo ndërmarrje tjetër;
5. Të jenë nënshtrë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

III. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR KONKURSIN E BURSIVE

1. Formulari për aplikim (merret te Fondacioni ose shkarkohet on-line);
2. Vërtetim për regjistrimin e semestrit për vitin akademik **2022/2023**;
3. Vërtetim i notave, transkriptë ose kopje të indeksit (ku mund të shihen të gjitha notat);
4. Dokumente për statusin social familjar:
 - Vërtetim nga punëdhënësi për prindërit/kujdestarët e punësuar;
 - Vërtetim nga Enti për punësim për prindërit/kujdestarët e papunësuar;
 - Fletëpagesë pensioni për anëtarët e pensionuar - Fondi pensional;
 - Çeku i ndihmës sociale - Banka deponente;
 - Për studentë pa prindër/njërën prind - Certifikatë vdekjeje (Drejtoria për udhëheqje me librat amë nga Komuna përkatëse);
5. Vërtetim nga Drejtoria për të Ardhurat Publike (DAP) për të dy prindërit/kujdestarët;
6. Kopje e ndonjë dokumenti identifikues (certifikatës së lindjes, letërnjoftim, pasaportë).

IV. VLERA E BURSËS DHE MËNYRA E REALIZIMIT

Vlera e bursës për vitin akademik 2022/2023 do të jetë **5.000,00 denarë**.

Pagesa e bursave do të realizohet në këste, përgjatë vitit akademik 2022/2023, përkatësisht 9 muaj, aq sa zgjatë viti akademik.

V. VENDI DHE AFATI PËR DORËZIMIN E DOKUMENTEVE

Aplikacioni dhe dokumentet e nevojshme kandidatët duhet t'i dorëzojnë në zyrën e **Fondacionit ALBIZ** në adresën: **rr. 20, nr. 97, Saraj – Shkup**.

Aplikimet bëhen në afatin vijues :

prej 17.10.2022 (e hënë) deri më 18.11.2022 (e premte)

Gjatë dorëzimit të dokumenteve, kandidatët duhet të kenë me vete letërnjoftimin ose ID-në.

Shpallja e rezultateve do të bëhet pranë zyrës së Fondacionit Albiz, në ueb faqen zyrtare www.albiz.org.mk si dhe në www.facebook.com/albizfoundation.

VI. SQARIM

1. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim duhet të dorëzohet personalisht nga vetë kandidati (përndryshe nuk do të pranohen);
2. Çdo person i cili do të konkurrojë do të marrë dëshmi (numër të dosjes). Studentët me numrin e dosjes do të identifikohen në të gjitha fazat e përcaktuara për tu përzgjedhur si bursist. Numri i aplikimit duhet patjetër të ruhet, deri në përmbylljen e konkursit;
3. Aplikimet e pakompletuara, gjegjësisht dokumentet që janë të pakompletuara dhe që dërgohen me vonesë, përkatësisht nuk i kanë respektuar afatet kohore të konkursit, nuk do të pranohen;
4. Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen prapa, mbeten në arkivin e Fondacionit;
5. Rezultatet do të shpallen me numra të dosjes (jo me emra).

Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në tel. **02 2057 632** ose në e-mail: info@albiz.org.mk, nga ora 08:00-16:00.